

Raporti i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor të RM

Hyrje

Raporti i monitorimit për punën e Këshillit Gjyqësor të RM, për periudhën kohore nga qershori 2018 deri në shtator 2018, është hartuar në kuadër të projektit *“Aksion për transparencë, llogaridhënie dhe efektivitet më të madh të Këshillit Gjyqësor të RM”*¹, me qëllim të vlerësimit të transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (KGJRM). Projekti i siguron kontinuitet Institutit për të Drejtat e Njeriut gjatë monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor, si vazhdimësi të projektit tanimë të implementuar: *“Monitorimi i shtuar publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM”*.²

Instituti për të Drejtat e Njeriut ka për qëllim më lehtë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse ta vlerësoj transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e punës së KGJRM përmes pjesëmarrjes në mbledhje publike, ndjekjes së ueb faqes dhe përmes qasjes së lirë deri te informacionet me karakter publik.

Raporti i monitorimit të transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të Këshillit Gjyqësor të RM u hartua në bazë të Metodologjisë për monitorim dhe matricës me indikatorë të përcaktuar.³

¹ <http://www.ihr.org.mk/project.php?pid=357>

² <http://www.ihr.org.mk/project.php?pid=104>

³ | publikuar në www.ihr.org.mk

TRANSPARENCA E KGJRM

Transparenca përmes mbledhjeve të hapura të KGJRM

	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
Mbledhje të hapura	1 mbledhje	1 mbledhje, 2 vazhdime	1 mbledhje	2 mbledhje dhe 1 vazhdim
Mbledhje të mbyllura		1 mbledhje		

Struktura e transparencës së mbledhjeve të hapura të KGJRM

Në mbledhjet publike të KGJRM respektohet parimi i transparencës dhe në numrin më të madh të rasteve, për pikat e rendit të ditës diskutojnë anëtarët e KGJRM, të cilët parashtojnë propozime ose vërejtje të tyre. Kryetari i KGJRM vëmendje të veçantë i përkushton arsyetimit të çdo pike të rendit të ditës e cila është e paqartë, jep sqarime dhe lë kohë të mjaftueshme për diskutim.

Disa herë, rendi i ditës, i cili është publikuar në ueb faqe, sipas të cilit zhvilloheshin punimet e mbledhjes nuk korrespondonte me rendin e ditës meqë në mbledhje propozoheshin pika të reja për shqyrtim. Arsyetimi për një gjë të këtillë është se këto pika duhet të shqyrtohen urgjentisht ose të njëjtat nuk janë publikuar, për shkak të neglizhencës së shërbimeve, megjithatë të njëjtat, në mbledhje të kolegjiut, anëtarët e KGJRM tanimë i kanë shqyrtuar. Kishte situata kur u propozuan pika të rendit të ditës për të cilat publiku është veçanërisht i interesuar, (pa marrë parasysh se bëhet fjalë për çështje për të cilat përjashtohet publiku në përputhje me ligjin). Kjo dukuri mund të shpie në perceptimin se me shmangien e vendosjes publike të këtyre pikave në rendin e ditës në ueb faqe, do të nxiste vëmendje më të madhe tek publiku dhe gazetarët, ndërsa në këtë mënyrë të njëjtat do të shqyrtohen pa publicitet më të madh, si dhe do të evitohen deklarata në lidhje me të njëjtat.

Lloje të publikimeve

Lloji i publikimit	Në kohë	I plotë	Vërejtje
Komunikatë	Në kohë	Pjesërisht	Komunikatat për mbledhjet e mbajtura janë të shkurtra. Theksohen vetëm pikat e miratuara të rendit të ditës pa arsyetim. Çdo njoftim është emërtuar si “komunikatë”, pavarësisht përmbajtjes të së njëjtës.
Vendime	Pjesërisht	Pjesërisht	Publikohen vetëm vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve

			të gjykatave, ndërsa vendimet e tjera nuk publikohen.
Procesverbale	Pjesërisht	Plotësisht	<p>Publikimi i procesverbaleve, në aspektin kohor, ndërlihet me miratimin në mbledhjen e KGJRM, ndërsa kjo mund të bëhet edhe pas disa javësh nga mbledhja për të cilën ka të bëjë procesverbali.</p> <p>Deri më tani, publiku nuk ka marrë pjesë gjatë votimit të pikave të cilat janë të mbyllura për publikun, madje as votimi i kësaj pjese nuk është pjesë përbërëse e procesverbaleve.</p> <p>Obligimi për transparencë të votimit, për pikat të cilat nuk janë publike si obligim ligjor, u inkorporua me ndryshimet ligjore në dhjetor të vitit 2017.</p>
Raportet	Në kohë	Pjesërisht	Raportet tremujore për punën e gjykatave, si dhe Raporti vjetor i KGJRM publikohen, por llojet e tjera të raporteve, të cilat janë në kompetencë të KGJRM, nuk publikohen në ueb faqe.
Informacione të tjera	Në kohë	Pjesërisht	Publikohen informacione nga vizitat më të rëndësishme të delegacioneve dhe ekspertëve, por edhe nga udhëtimet jashtë vendit për pjesëmarrje në konferenca.

Prezenca e Këshillit Gjyqësor në publik

Periodha kohore për të cilën është hartuar Raporti i Monitorimit përputhet me pushimin e gjykatave, kështu që në këtë periudhë nuk ka aktivitete të rëndësishme të Këshillit Gjyqësor për t'iu drejtuar publikut të gjerë. Një interesim më i madh për punën e KGJRM medias manifestuan pas deklaratës së kryetarit lidhur me Raportin e PSP. Deklarata e tij, të cilën e dha në muajin shtator për TV 24, u transmetua në më shumë media.

Analiza e përmbajtjeve të publikimeve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (transparencë thelbësore)

- ✚ Për aktivitetet e kryetarit dhe anëtarëve të KGJRM, mund të mësohet nga komunikatat të cilat publikohen në ueb faqe. Ato përmbajnë informacione bazike për ndonjë takim ose ngjarje, pa u futur thellë në esencën e takimit të mbajtur ose për pjesëmarrjen në ngjarje. U vendos praktika që pas çdo mbledhje, në të cilën marrin pjesë gazetarë dhe media, kryetari të jap deklaratë lidhur me temat e mbledhjes, si dhe t'u përgjigjet pyetjeve të parashtruara nga gazetarët.

Analiza e përmbajtjes së një pjese të paraqitjeve në media, deklaratave, intervistave, debateve, me qëllim që të vlerësohet dimensiononi ose kualiteti i përmbajtjes së raportimit për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë;

- ✚ Zgjedhja e anëtarit të KGJRM nuk u mbulua mjaftueshëm nga mediat, megjithatë edhe KGJRM në masë të pamjaftueshme e njoftoi publikun për zgjedhjen. Së këtejmi, në ueb faqe u publikua një komunikatë e shkurtër në të cilën ishte theksuar vetëm emri i anëtarit të sapo zgjedhur, pa u dhënë informacione relevante dhe më të hollësishme (sa gjyqtarë kanë votuar, me sa vota është zgjedhur anëtari i ri, etj.).

LLOGARIDHËNIA E KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Me ndryshimet ligjore, të miratuara në dhjetor të vitit 2017, KGJRM e ka për obligim që Raportin vjetor për punën e tij, për vitin paraprak, t'ia paraqes Kuvendit të RM më së voni deri më 30 prill të vitit rrjedhës. Deri më tani publiku nuk është njoftuar se cilët do të jenë hapat e ardhshëm të Kuvendit të RM-së në lidhje me Raportin për punën e KGJRM për vitin 2017, meqë Komisioni për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive pranë Kuvendit të RM nuk i dha dritë të gjelbër miratimit të tij. Nga informacionet në dispozicion mund të vërehet se kryetari i KGJRM, më 3 shtator të vitit 2018 e mbronte Raportin vjetor për punën e KGJRM për vitin 2016, ndërsa votimi për të njëjtin do të zhvillohet në njërin nga vazhdimet e ardhshme të seancës së 32-të të Kuvendit të RM-së. Nga këto të dhëna mund të konkludojmë se, sa i përket

miratimit të vendimit për (mos) miratimin e dy raporteve të fundit vjetor të KGJRM, Kuvendi i RM-së vepron në mënyrë joefektive.

EFEKTIVITETI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

- Në gjysmën e parë të vitit pjesa më e madhe e gjykatave janë efektive, megjithatë, disa gjykata nuk kanë pasur sukses të përballen me zgjidhjen e prurjeve të lëndëve të reja kështu që konsiderohen si joefektive. Shkak për këtë është numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve në gjykatat themelore, mungesa e pajisjes teknike, si dhe mungesa e mjediseve dhe kapaciteteve njerëzore për funksionim normal të gjykatave. Nuk janë të dukshme veprimet e ndërmarra nga KGJRM për zbutjen e kësaj situatë.
- Zgjedhja e anëtarit të KGJRM (nga radhët e gjyqtarëve pjesëtarë të të gjitha bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë) u mbajt më 5 shtator të vitit 2018. Madje, në fund të muajit shtator procesverbali nga komisioni i cili e realizoi zgjedhjen iu dorëzua anëtarëve për shqyrtim. Komisioni për zgjedhje ka konstatuar se në disa vende zgjedhore nuk është respektuar procedura për rrjedhën dhe kohën e fillimit dhe përfundimit të votimit në përputhje me ligjin. Kjo është bërë me vetiniciativë nga këshillat zgjedhorë në këto vende të votimit të cilët votimin e kanë ndërprerë para orës 15:00, duke i trajtuar gjyqtarët të cilët nuk kanë votuar sikur mungojnë në punë, edhe pse bëhet fjalë për të drejtë ligjore për votim, të njëjtit është dashur të presin deri në ora 15:00 kur përfundon votimi dhe kur mbyllen vendet zgjedhore. Kjo situatë nuk ka ndikuar mbi rezultatet zgjedhore.⁴ Deri te Komisioni nuk është paraqitur asnjë kundërshtim për pamundësimin e të drejtës së votës.

Numri i gjyqtarëve të regjistruar në ekstraktin e Regjistrimit gjyqësor zgjedhor në nivel të Republikës së Maqedonisë si njësi zgjedhore përfshinë 511 gjyqtarë.

Numri i gjyqtarëve që kanë dal të votojnë është 471 votues.

Numri i fletëvotimeve të pavlefshme është 18 fletëvotime.

Numri i fletëvotimeve të papërdorura është 40 fletëvotime.

Numri i votave që i ka fituar çdo kandidat:

1. Nazif Ilijazi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Tetovë, - 18
2. Naser Haxhi-Ahmetagiq, gjyqtar në Gjykatën Themelore Shkup I - 88
3. Safet Kadrii, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkup - 33
4. Sashko Georgiev, gjyqtar në Gjykatën Themelore Shtip - 152
5. Sulejman Memeti, gjyqtar në Gjykatën Themelore Shkup I - 75
6. Qenanzija Mehmed, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkup - 87

⁴ [Raporti i Komisionit për zbatimin e zgjedhjes të anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nga radha e gjyqtarëve pjesëtarë të të gjitha bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë](#)

- Gjatë muajit shtator u miratua vendimi të shpallen zgjedhe për 6 anëtarë të rinj të Këshillit Gjyqësor, mandati i të cilëve skadon më 18.12.2018, prej të cilëve pesë janë nga radhët e gjyqtarëve dhe një nga radhët e juristëve të shquar që zgjidhet me propozim të Presidentit të RM.
- Edhe pse që në muajin dhjetor të vitit 2017 deri te KGJRM u dërgua Raporti për (keq) përdorimin e sistemit AKMIS, të cilin e përpiloi një grup pune i pavarur i cili i bëri hulumtimet e nevojshme, prapë se prapë edhe pas përfundimit të kësaj periudhe raportuese, nuk janë të dukshme veprimet e ndërmarra nga KGJRM, me qëllim të konfirmimit dhe evitimit të parregullsive. Ky është një tregues për efektivitetin e pamjaftueshëm në këtë pjesë, e që ndikon negativisht mbi pavarësinë e gjyqësorit për të cilën duhet të kujdeset KGJRM.
- Pas publikimit të Raportit gjashtëmujor nga PSP, në të cilin disa gjyqtarë publikisht, me emër dhe mbiemër, ishin apostrofuat se e kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit pa integritet moral, KGJRM nuk ka ndërmarrë asnjë veprim, me qëllim të mbrojtjes së pavarësisë së gjyqësorit.

Parashtresa

(Numri i parashtresave të shqyrtuara sipas muajve dhe numri i parashtresave të zgjidhura) me rezultatet si vijojnë: në muajin korrik janë shqyrtuar 98 parashtresa, të zgjidhura 90, të prolonguara 8. Në muajin shtator janë shqyrtuar 106 parashtresa, të zgjidhura 94, të prolonguara 11, ndërsa 1 parashtresë është tërhequr

- ❖ Konform kompetencave ligjore, KGJRM e ka për detyrë që së paku një herë në muaj t'i shqyrtoj parashtresat dhe ankesat e qytetarëve dhe personave juridikë për punën e gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave. Mund të vërehet se parashtresat dhe ankesat më së shpeshti refuzohen si të pabaza ose hidhen poshtë, meqë Këshilli nuk është kompetent të veproj për disa prej tyre, por edhe palët nuk kanë njohuri adekuate në cilat raste dhe në cilat baza parashtrrohet parashtresë deri te KGJRM.
- ❖ Përmbajtja e parashtresave dhe ankesave kryesisht mbështetet në pretendime ankimore, në të shumtën e rasteve nuk ka motive të qarta për punë të pandërgjegjshme dhe joprofesionale të gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës dhe nuk parashtrrohen prova për të njëjtën.
- ❖ Qëndrimi i KGJRM konsiston me atë se roli i tyre nuk është të ndërhyj në pjesën e vendimit të gjyqtarit, meqë për këtë janë kompetente gjykatat më të larta, veçanërisht kur bëhet fjalë për aktgjykim të miratuar të plotfuqishëm.